

URDHËR
Nr. 987, datë 24.5.2019

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 28, gërma “d” e ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të neneve 28 dhe 29 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, në funksion të mbarëvajtjes të veprimtarisë administrative dhe zbatimit të detyrimeve të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës për të trajtuar dhe nënshkruar shkresat me karakter njohës dhe informues, sipas fushës përkatëse të përgjegjësisë, drejtorëve të njësive në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së, si vijon:

- Drejtorit të Njesisë së Titujve të Pronësisë, z. Eljon Semanaj;
- Drejtorit të Njesisë së Kadastrës dhe Hartografisë, z. Andi Proko;
- Drejtorit të Njesisë Juridike dhe të Kontrollit, zj. Jeta Velaj;
- Drejtorit të Njesisë së Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, zj. Brikena Dervishaj.

2. Shkresat informuese të Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së, që u drejtohen të tretëve (persona fizikë, persona juridikë privatë dhe publikë), si dhe ato drejtuar strukturave të varësisë të ASHK-së, në funksion të informimit të të tretëve, të nënshkruhen nga drejtorët e Njësive të përmendur në pikën 1 të këtij urdhri, sipas detyrave funksionale dhe përgjegjësi të secilës njësi.

Përfshimisht, shkresat që i drejtohen Presidentit të Republikës, Kryeministrit, ministrave, sekretarëve të përgjithshëm të ministrive, si dhe kryetarëve të bashkive, nënshkruhen nga Drejtori i Përgjithshëm.

3. Delegimi i kompetencës sipas këtij urdhri, nuk përfshin aktet dhe shkresat me karakter vendimmarrës. Shkresat që trajtojnë problematika, mosmarrëveshje administrative, apo civile, ose që kërkojnë nxjerrjen e akteve administrative/kryerjen e veprimeve administrative, nënshkruhen nga Drejtori i Përgjithshëm.

4. Pavarësisht delegimit të kompetencave sipas këtij urdhri, Drejtorët e njësive, nëse e gjykojnë të nevojshme, mund t'i përcjellin për këshillim apo nënshkrim Drejtorit të Përgjithshëm, shkresat me natyrë informuese që ata i vlerësojnë të rëndësishme të veçantë.

5. Në rast mungese në detyrë të subjekteve të përmendur në pikën 1 të këtij urdhri, delegimi i kompetencës konsiderohet i ndërprerë për periudhën e mungesës, në kuptim të nenit 29, pika 2, gërma “ç” të “Kodit të Procedurave Administrative”.

Gjatë mungesës, kompetenca ushtrohet nga Drejtori i Përgjithshëm i ASHK-së.

6. Ngarkohen njësitë dhe drejtuesit e tyre të përmendur në pikën 1 dhe sektori i Arkivës dhe Protokollit, në Drejtorinë e Përgjithshme, për zbatimin e këtij urdhri.

7. Urdhri nr. 547, datë 10.5.2019 i Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK-së, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM
Artan Lame